

V E N D I M
Nr.210, datë 10.5.1993

PËR SHËRBIMIN E ROJAVE CIVILE

Në bazë e për zbatim të ligjit nr.7696, datë 7.4.1993 "Për shërbimin e rojave civile", Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Rendit Publik është organi që pajis me licencë firmat private të krijuara posaçërisht për shërbimin e rojave civile dhe personat privatë që nuk bëjnë pjesë në firmë.

2. Firmat private të krijuara posaçërisht për shërbimin e rojave civile dhe personat privatë që nuk bëjnë pjesë në firmë e që kërkojnë të pajisen me licencë për të ushtruar veprimtarinë në përputhje me nenin 3 të ligjit, duhet të paraqesin kërkesën në organet e rendit publik të rrethit ku banojnë.

Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin e parashikuar në nenin 5 të ligjit, vendimin e gjykatës, statutin e veprimtarisë së firmës ose personi privat, objektet që do të sigurohen, listën emërore të rojave civile që do të punësojnë, si dhe rregulloren e brendshme të objekteve që do të sigurojnë.

Organet e rendit publik në rrethe, pasi shqyrtojnë kërkesën, dokumentacionin dhe bazueshmërinë e tyre në ligj, i japin pëlqimin Ministrisë së Rendit Publik për pajisjen me licencë.

3. Në Ministrinë e Rendit Publik krijohet komisioni i testimit të firmave private të krijuara posaçërisht për shërbimin e rojave civile e personave privatë që nuk bëjnë pjesë në firmë, kurse në degët e rendit publik në rrethe krijohet komisioni i testimit të shtetasve që do të merren në detyrën e rojës civile.

4. Ministria e Rendit Publik përgatit kërkesat e testimit, aktet nënligjore përkatëse dhe ua dërgon organeve të rendit publik në rrethe, që kanë për detyrë të bëjnë përgatitjen profesionale të drejtuesve të firmave private e personave privatë të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi. Këta të fundit kanë për detyrë të organizojnë përgatitjen profesionale të rojave civile sipas programit të miratuar nga Ministria e Rendit Publik.

5. Detyrimet që rrjedhin nga ligji ndërmjet organit të rendit publik, firmave e personave privatë që merren me shërbimin e rojave civile, përcaktohen në kontratën që do të lidhet ndërmjet palëve.

6. Rojat civile të armatosura, kur pushohen nga puna, u mbaron afati i kontratës së punësimit, si dhe largohen me kërkesën e tyre, duhet që nga firma private dhe personi privat që i ka punësuar, të njoftohet me shkrim dega e rendit publik në rreth brenda 24 orëve. Rojat civile detyrohen që brenda 72 orëve të dorëzojnë në organet e rendit publik armatimin, municionin, lejen e ushtrimit të profesionit, pajisjet dhe dokumentet e tjera të dhëna nga këto organe.

7. Firmat dhe personat privatë që merren me shërbimin e rojave civile, për ruajtjen dhe administrimin e armatimit, janë të detyruar të zbatojnë rregullat e forcave të armatosura. Armatimi duhet të sigurohet në armatura e kasaforta dhe dhënia e armëve duhet të bëhet me libër shërbimi.

Pas mbarimit të shërbimit rojat civile janë të detyruar t'i dorëzojnë armët dhe u ndalohet të qëndrojnë me uniformë.

8. Vendimi i Këshilli të Ministrave nr.264, datë 22.6.1992 "Për objektet që sigurohen me roja civile të armatosura", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi